URDHËR
Nr. 18, datë 17.1.2020

PËR MBYLLJEN E VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONIT ARSIMOR JOPUBLIK TË ARSIMIT TË MESËM TË LARTË, "SAADI", TIRANË

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikave 3 dhe 7, të nenit 42, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; të vendimit nr. 505, datë 13.9.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë"; të udhëzimit nr. 15, datë 12.7.2013, "Për procedurat e posaçme për shqyrtimin e kërkesave për licencë të institucioneve arsimore private dhe institucioneve arsimore plotësuese private parauniversitare", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor jopublik të arsimit të mesëm të lartë, "SAADI", Tiranë, licencuar me urdhrin nr. 361, datë 1.12.2000, të ministrit të Arsimit dhe Shkencës, "Për dhënie leje funksionimi të institucionit arsimor jopublik", të ndryshuar me urdhrin nr. 360, datë 5.11.2009.

2. Institucioni arsimor jopublik "SAADI", Tiranë, ka për detyrë:

a) të kthejë pagesat e kryera nga nxënësit për pjesën e papërfunduar të shkollimit, si dhe çdo detyrim tjetër të papërmbushur që mund të ketë ndaj tyre;

b) të pajisë çdo nxënës me dokumentacionin e nevojshëm shkollor që do të shërbejë për transferimin e tij në një institucion tjetër të arsimit parauniversitar;

c) të vërë në dispozicion të Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar, Tiranë, çdo informacion të kërkuar deri në plotësimin dhe mbylljen e të gjitha kërkesave të parashikuara në këtë urdhër;

d) të mbulojë të gjitha shpenzimet për kryerjen e procedurave për transferimin e nxënësve, në zbatim të këtij urdhri;

e) të dorëzojë në Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar, Tiranë, të gjithë dokumentacionin lidhur me veprimtarinë e kryer.

3. Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar, Tiranë, ka për detyrë:

a) të ngrejë grup pune brenda 3 (tri) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri dhe të marrë masat për mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor jopublik "SAADI", Tiranë;

b) të marrë masat për transferimin e nxënësve në institucione të tjera të arsimit parauniversitar për të gjithë nxënësit e regjistruar në këtë institucion arsimor;

c) të administrojë të gjithë dokumentacionin lidhur me veprimtarinë mësimore të kryer nga institucioni arsimor parauniversitar jopublik;

d) të ruajë në arkivin e institucionit dhe, më tej, të arkivojë sipas ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003, "Për arkivat", dokumentacionin e dorëzuar nga institucioni arsimor jopublik.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar dhe Drejtoria Rajonale Arsimore Parauniversitare, Durrës të monitorojnë veprimtarinë e Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar, Tiranë, për zbatimin e detyrave sipas këtij urdhri.

5. Urdhri nr. 361, datë 1.12.2000, i ministrit të Arsimit dhe Shkencës, "Për dhënie leje funksionimi të institucionit arsimor jopublik", i ndryshuar me urdhrin nr. 360, datë 5.11.2009, shfuqizohet.

6. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë për Arsimin, Sportin dhe Rininë në MASR, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Drejtoria Rajonale Arsimore Parauniversitare, Durrës, Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar, Tiranë, institucioni arsimor jopublik "SAADI", Tiranë dhe Fondacioni "RUMI", përfaqësuar nga z. Seyed Amirhossein Asghari.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Besa Shahini